



Narcotics Anonymous

Kush është i varur?

Shumica prej nesh nuk ka nevojë të mendojë shumë për këtë pyetje. E DIMË! E gjithë jeta dhe mendimi ynë rrotullohej rreth drogave të çdo forme — t'i gjenim, t'i përdornim dhe të shpiknim mënyra dhe metoda për të siguruar më shumë. Ne jetonim për të përdorur dhe përdornim për të jetuar. Shumë thjesht, një i varur është një burrë ose grua, jeta e të cilit kontrollohet nga droga. Ne jemi nën ndikimin e një sëmundjeje të vazhdueshme dhe progresive, fundi i së cilës është gjithmonë i njëjtë: burgje, institucione dhe vdekje.